



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	31-07-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstva Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shiujta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SDM8H0	5457	2023	115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.177/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1992/2021 të datës 11.07.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.177/2020 të datës 01.07.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit me Nr. 14-070/01-0057733/20 të datës 22.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "Pezullim parandalues-kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.177/2020 e datës 01.07.2020 të parashtruar nga ankuesi lidhur me pretendimin për kompensim të pagës.

II.Përfundon Procedimi Administrativ lidhur me pretendimin e ankuesit për kthim në vendin e punës.

III.Shfuqizohet Vendimi me Nr. 14-070/01-0057733/20 i datës 22.06.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.

IV.Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagave për ankuesin Ramush Thaqi sipas kërkesës së datës 09.02.2023, dhe atë nga data 03.02.2020 deri më datë 01.01.2023.

V.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Akt Emërimit me numër 01 nr.112-19 të datës 18.12.2019 në pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit” në Komunën e Prishtinës, Kryetari i Komunës së Prishtinës, pas marrjes së njoftimit të datës 31.01.2020 nga Prokuror i Shtetit, më datë 03.02.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 14-118/02-26468/20 përmes të cilit ka bërë pezullimin parandalues me 50% të pagës deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Ankuesi më datë 10.03.2020 kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, më datë 22.06.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 14-070/01-0057733/20 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 10.03.2020.

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 01.07.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1248/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për anulimin e këtyre vendimeve dhe kthimin në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ndërsa ankuesi më datë 17.08.2020 është njoftuar për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke e udhëzuar që pala mund të fillon konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative, kështu që ankuesi ka vazhduar me hapjen e konfliktit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 25.06.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1562/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 17.08.2020 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit, mirëpo gjatë kësaj periudhe Këshilli në mungesë të kuorumit më datë 17.08.2021 ka njoftuar ankuesin që rasti nuk është shqyrtuar duke e njoftuar që mund të fillon konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 11.07.2023 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1992/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 17.08.2021 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 01.07.2020 të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1248/2020 të datës 01.07.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.14-070/01-0057733/20 të datës 22.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Vendimin me Nr. 14-118/02-26468/20 të

datës 03.02.2020 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Ankesën e datës 10.03.2020 të parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.07.2020; Përgjigjen në ankesë e datës 21.07.2020; Akt Emërimit 01nr.112-19 të datës 18.12.2019; Njoftimin e datës 31.01.2020 të Prokurorit të Shtetit; Njoftimin e datë 17.08.2020 dhe 17.08.2021 nga Këshilli për Ankuesin; Aktgjykimin A.nr.1992/2021 të datës 11.07.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin A.nr.1562/20 të datës 25.06.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën për informata zyrtare e datës 14.07.2023; Përgjigjen e datës 18.07.2023 nga Komuna e Prishtinës; Vendimin me Nr. 14-101/03-0271157/22 I datës 19.12.2020 I Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Kërkesën për pagesën e pagave dhe kontributeve për ankuesin e datës 0-9.02.2023 nga Komuna e Prishtinës për zv. Drejtorin e Thesarit; Kërkesë për pagesë retroaktive shkurt 20232 nga Komuna e Prishtinë për Thesarin e Kosovës; Emailin e datës 16.03.2023 për dhe Emailin e datës 11.02.2023 nga për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar së janë pjesërisht të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar më datë 01.07.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 14-070/01-0057733/20 të datës 22.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, pretendon që vendimet e nxjerra në raport me të janë të kundërligjshme duke kërkuar që të njëjtat të anulohen dhe të kthehet ne vendin e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës nga dita e pezullimit.

Siç theksuar edhe më lartë Prokurori i Shtetit më datë 31.01.2020 ka njoftuar Komunën e Prishtinës së ndaj ankuesit Ramush Thaqi është ngritur aktakuzë me shenjë PP.nr.41/2013 të datës 09.08.2016 për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 i ish-KPRK-së, ndërsa Kryetari i Komunës së Prishtinës, më datë 03.02.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 14-118/02-26468/20 përmes të cilit ka bërë pezullimin parandalues me 50% të pagës deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Pas pranimit të Aktgjykimin PAKR.nr.248.2022 të datës 30.11.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Komunës së Prishtinës, më datë 19.12.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 14-101/03-0271157/22 përmes të cilit ankuesi është kthyer në vendin e punës sipas akt emërimit nga data 01.01.2023, duke vendosur që ndaj ankuesit të bëhet kompensimi i 50% të pagës nga dita e pezullimit parandalues datë 03.02.2020, dhe duke e shfuqizuar Vendimit me Nr. 14-118/02-26468/20 të datës 03.02.2020.

Komuna e Prishtinës më datë 09.02.2023 ka përcjell tek Zëvendësdrejtori i Thesarit të Kosovës kërkesën për pagesën e pagave dhe kontributeve për ankuesin duke bashkangjitur edhe kërkesën për pagesë retroaktive, mirëpo sipas njoftimit të datës 18.07.2023 është konfirmuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës se Thesari i Kosovës nuk ka bërë kompensimin e pagave për ankuesin.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kthim në vendin e punës, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi sipas Vendimit me Nr.14-101/03-0271157/22 të datës 19.12.2020 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës ankuesi është kthyer në vendin e punës në pozitën *“Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit”* në Komunën e Prishtinës, kështu që objekti i ankesës sa i përket këtij pretendimi është përmbushur, rrjedhimisht ky pretendim është bërë i pamundur në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit për kthim në punë me të gjitha të drejtat duke njohur të drejtat nga dita e pezullimit që nënkupton edhe çështjen e pagës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky pretendim është i bazuar në kuptim të nenit 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (që ka qenë në fuqi), është përcaktuar se: *“Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës”*, sepse në bazë të këtij paragrafi të këtij neni periudha e mungesës në punë do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi, kështu që sipas Kolegjit të Këshillit, ligjërisht ankuesit i takon kompensimi i 50% të pagës nga data 03.02.2020.

Meqenëse Komuna e Prishtinës, respektivisht Kryetari i Komunës sipas Vendimit me Nr.14-101/03-0271157/22 të datës 19.12.2022, ka ndërmarr të gjitha veprimet ligjore që përveç kthimit të ankuesit në vendin e punës, ka vendosur t'i njihet e drejta edhe e kompensimit të 50% të pagës nga dita e pezullimit dhe megjithëse ky vendim me gjithë dokumentacionin përkatës është dërguar për ekzekutim në Thesarin e Kosovës, atëherë Kolegji i Këshillit në kuptim të respektimit të normave ligjore të cekura si më lartë konstaton se Komuna e Prishtinës ka përmbushur obligimin ndaj ankuesit, ndërsa tani çështja e kompensimit të 50% të pagesë për ankuesin bie në barrë të Thesarit të Kosovës, kështu që sipas këtij vendimi obligohet Drejtori i Thesarit të Kosovës që në kuptim të kërkesës së datës 09.02.2023 të Komunës së Prishtinës të bëjë kompensimin e pagave për ankuesin në vlerën 50% nga dita e pezullimit të marrëdhënies së punës deri në ditën e kthimit në punë bazuar në dokumentacionin që ka ofruar komuna e Prishtinës sa i përket kompensimit.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr.14-070/01-0057733/20 të datës 22.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, konstaton se ky vendim është nxjerr jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 135 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Përpos kur ligji parashih një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës”*, dhe nenin 9 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve edhe Ankesave, ngase ankesa e ankuesit pranë këtij komisioni është e parashtruar më datë 10.03.2020 ndërsa vendimi i kontestuar me ankesë është nxjerr më datë 22.06.2020, si rezultat i kësaj ky vendim është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit përkatësisht nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.177/2020, datë 31/07/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMShCK- së.